

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË
VERIUT

PROPOZUES: Shërbimi profesional i Fondit

PËRGATITËS: Sektori për çështje financiare

RAPORTUES: Ajredin Amzai, ndih. drejtor

PROPOZIM – PLANI STRATEGJIK
I FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË
VERIUT PËR PERIUDHËN 2020-2022

Në bazë të nenit 157 pika 16 të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor (“Gazeta zyrtare e R.M-së” nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 13/16, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18) dhe nenit 33 të Statutit të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e R.M-së” nr. 174/2013), Këshilli drejtues i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 08 gusht të vitit 2019, solli:

**PLANI STRATEGJIK
I FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË
VERIUT PËR PERIUdhËN 2020-2022**

Shkup, gusht 2019

1. HYRJE

Plani strategjik i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut (2020-2022) është në mbështetje me ligjin për sigurim pensional dhe invalidor dhe Planin vjetor dhe programin për punën e Fondit të sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut.

Me Ligjin e sigurimit pensional dhe invalidor janë rregulluar të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor për të gjithë të siguruarit.

Punët administrative, financiare, profesionale dhe çështjet e tjera të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut i zbaton Shërbimi profesional i Fondit edhe atë, në Qendër, 20 filiale dhe 10 Ekspozitura.

Organet e Fondit janë Këshilli drejtues i Fondit dhe Drejtori i Fondit. Për punën e tij, Këshilli drejtues i Fondit është përgjegjës para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me çka, çdo vit dorëzon Raport vjetor për punën e Fondit.

Këshilli drejtues formon komisione të përhershme dhe të përkohshme dhe trupa të tjerë punues për ndjekjen e çështjeve të caktuara në zhvillimin dhe zbatimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, zgjidhjen e të drejtave të të siguruarve dhe përfituesve të pensionit dhe shqyrtimin e çështjeve në fushëveprimin e Këshillit drejtues.

Kompetenca, përbërja, mënyra e punës dhe çështjet e tjera të punës së komisioneve si dhe trupave të tjerë punues të Këshillit drejtues përcaktohen me Rregulloren e Këshillit drejtues.

Drejtori udhëheq me Fondin dhe e përfaqëson atë para personave të tretë, ndërsa për punën e tij është përgjegjës para Këshillit drejtues të Fondit dhe para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtori propozon Programin dhe Planin për punë dhe ndërmerr masa për realizimin-zbatimin e tyre, organizon dhe siguron realizimin ligjor dhe efektiv të punëve në kuadër të fushëveprimit të Fondit , ndërsa Këshillit drejtues të Fondit rregullisht i dorëzon raporte dhe analiza mbi çështjet e të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor.

Drejtori i Fondit ka zëvendës. Zëvendësdrejtori e zëvendëson drejtorin e Fondit gjatë mungesës së tij dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me Statutin e Fondit.

Puna në Qendrën e Fondit kryhet në kuadër të katër sektorëve. Me sektorët udhëheqin ndihmësdrejtorët. Aktin mbi organizimin e punës dhe sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin profesional të Fondit e përfshin struktura organizative e cila tregon ndarjen e brendshme të punës dhe të marrëdhënieve ndërmjet sektorëve të veçantë. Detyrat, përgjegjësitë dhe lidhshmëria ndërmjet pozicioneve individuale të punës janë bazuar në strukturën organizative të Fondit.

Në rrjedhë të vitit 2020-2022, Ministria e punës dhe politikës sociale në bashkëpunim me Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut planifikon të zhvillojë një projekt për rekreacion, gjegjësisht rekreacion klimaterik në banjë për përfituesit e pensionit.

2. ZHVILLIMI I PROCESIT MBI PLANIFIKIMIN STRATEGJIK

Me buxhetin e Fondit planifikohen dhe propozohen që shumat vjetore të të drejtës për shpenzim, për qëllime të caktuara dhe të drejtat e njejta për shpenzime janë kufizuar me realizimin e planit të të hyrave.

Fondi punon në përputhje me kufizimin e të drejtës së buxhetit për shpenzim dhe nuk ndërmerr për obligim të drejtën e caktuar mbi shpenzimet.

Buxhetin e Fondit e përcakton Këshilli drejtues i Fondit, ndërsa e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut si pjesë përbërëse e Buxhetit të Vendit.

Procesi i Buxhetit përbëhet nga tri faza kryesore që realizohen në periudha të ndryshme kohore, edhe atë:

Procesi i buxhetit

Gjatë përgatitjes së Buxhetit të Fondit merret parasysh politika makroekonomike në të cilën janë definuar prioritetet qeveritare, ndërsa janë përmbajtur edhe indikatorët makroekonomik për lëvizjen e punësimit dhe pagat që janë bazë për planifikimin e të hyrave dhe të dalave të Fondit.

Ministria e financave përgatit qarkoren Buxhetore në të cilën janë paraqitur udhëzimet kryesore për përgatitjen e Buxhetit të Fondit. Në bazë të qëllimeve të parapara në qarkore, Fondi përgatit buxhetin duke marr parasysh nivelin e arritur të të hyrave dhe të dalave si dhe dispozitat ligjore të sigurimit pensional dhe invalidor.

Qarkorja buxhetore

Qarkorja buxhetore dorëzohet te të gjithë shfrytëzuesit buxhetor dhe fondet dhe pas marrjes të së njëjtës në Fond fillon procesi i përgatitjes së Propozim-kërkesës buxhetore.

Pas miratimit të politikave makroekonomike dhe marrjes së qarkores Buxhetore fillojnë aktivitetet e Fondit për përgatitjen e Propozim-kërkesës buxhetore.

Ky proces i definon të hyrat dhe të dalat e Fondit për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor dhe përfshin disa faza:

- Analiza e nivelit të arritur të të hyrave dhe të dalave dhe vlerësime deri në fund të vitit;
- Vlerësim i të hyrave të Fondit sipas llojit të të hyrave dhe llojit të të dalave.

Indikatorët makroekonomik për llogaritjen e kontributeve janë rritja e pagave dhe rritja e të punësimit, ndërsa në pjesën e të dalave janë rritja e pagave dhe rritja e shpenzimeve për jetë dhe në bazë të këtyre parametrave përcaktohet përqindja e harmonizimit të pensioneve.

Propozim – buxheti i përgatitur i Fondit dorëzohet deri te Këshilli drejtues i Fondit për shqyrtim dhe miratim dhe nëse dalin aktivitete të reja apo përjashtim i disa aktiviteteve, bëhet korigjim, gjegjësisht harmonizim i Buxhetit. Buxheti i përcaktuar dorëzohet deri te Ministria e financave.

Nga koha që kryhet harmonizimi i kërkesës buxhetore me propozim të Ministrisë për financa, Ministria e financave e dorëzon Buxhetin e Fondin si pjesë përbërëse e Buxhetit të Vëndit deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Zbatim buxhetor

Ky proces është zbatim i Buxhetit sipas limeteve të përcaktuara të të drejtave buxhetore për shpenzim. Fondi nuk guxon të ndërrmer obligime mbi të drejtat e përcaktuara për shpenzime në vitin për të cilin është i sjellë buxheti.

Gjatë përgatitjes së buxhetit shfrytëzohen programe me qëllim që të shfaqen financime të veçanta për aktivitete të caktuara apo për një grup të aktiviteteve.

Planifikimi i buxhetit përfshin vlerësime për tre vite me të cilat planifikohen të hyra dhe të dala globale, përkatësisht paraqiten me më pak detaje.

Vizioni

Vizioni i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut është që në të ardhmen ai të përfaqësojë një institucion modern me administratë profesionale dhe kompetente i cili do të sigurojë një shërbim të mirë, të shpejtë, kualitativ dhe në kohë për klientët, që do të ketë bashkëpunim kualitativ me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të kryejë pagesë të rregullt të pensioneve dhe në kohë të duhur në mbështetje të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor si dhe në mbështetje të Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Misioni

Misioni i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut është realizimi i vizionit nëpërmjet:

- Modernizimit të procesit për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor;
- Sistemit modern informatik i cili ofron mbrojtjen maksimale dhe sigurinë e të dhënave të të siguruarve dhe obliguesve dhe i cili në vazhdimësi përmirësohet në mbështetje me arritjet e fundit në teknologjinë e informatikës;
- Sigurimit të kushteve më moderne për jetesë në shtëpitë e shfrytëzuesve të pensionit;
- Ndjekjes dhe harmonizimit të sistemit pensional në aktet ndërkombëtare;
- Shërbimit kompetent profesional dhe përmirësimit të vazhdueshëm të saj përmes organizimit dhe ndjekjes së trajnimeve;
- Përgjegjësisë shoqërore duke ju shpjeguar të siguruarve mbi realizimin e të drejtave të SPI përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe materialeve të shtypura informatike, pjesëmarrjes në aksionet për dhurimin e gjakut, ekologjike dhe aksione tjera, bashkëpunimit me lidhjet dhe shoqatat e pensionistëve dhe të tjera.

Qëllimet e përgjithshme

1. Shërbime cilësore dhe në kohë të klientëve të cilët realizojnë të drejta të SPI;
2. Pagesë të rregullt, në kohë dhe të saktë të pensioneve në Vend dhe jashtë vendit në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital;
3. Ligjshmëri në punë dhe zbatimin e dispozitave materiale nëpërmjet revizionit të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohen të drejtat e SPI-së;
4. Bazë e saktë, kualitative dhe azhurnuese e të dhënave për të gjithë të siguruarit , obliguesit për pagesën e kontributeve të sigurimit pensional dhe invalidor;
5. Shërbimi profesional dhe zhvillimi i tij i kontinuar profesional;
6. Përdorimi i sistemit modern të informatikës i cili ofron mbrojtjen maksimale të të dhënave të klientëve;
7. Sigurimi i kushteve optimale për jetesë në shtëpitë e përfituesve të pensionit;
8. Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë në Bashkimin Evropian dhe

përforcimin e kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinimin e sistemit të sigurimit social.

Qëllimet specifike

Shërbime cilësore dhe në kohë të klientëve të cilët realizojnë të drejtat e SPI-së.

1. Menaxhimi i sistemit për cilësinë e shërbimeve, proceseve dhe punonjësve në Fondin e SPIMV-së	
Gjendja aktuale	Fillimi i implementimit të ISO 9001:2015 standardit
Gjendja e ardhshme	Mirëmbajtja e sistemit në menaxhimin e cilësisë, ISO 2001:2015
Përgjegjës	Menaxher i cilësisë
2. Të dhënat e sakta, complete dhe azhurnuese të të siguruarve dhe obliguesve	
Gjendja aktuale	Përcaktimi i të dhënave të plota për të siguruarit dhe obliguesit
Gjendja e ardhshme	Qasje elektronike falas deri tek të dhënat e evidentuara
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI
3. Procesimi i plotë i lëndëve pensionale në mënyrë elektronike	
Gjendja aktuale	Përveç lëndëve elektronike, paralelisht përdoret edhe forma në letër
Gjendja e ardhshme	Përkrahje e plotë aplikuese e të gjitha të drejtave të SPI-së
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI dhe Sektori i informatikës
4. Pagesa e mjeteve për Fond solidar	
Gjendja aktuale	Pagesë në kohë e mjeteve për fondin solidar
Gjendja e ardhshme	Pagesë e mjeteve për fondin solidar në afate sa më të shkurtëra
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare
5. Shkurtimi i afateve për realizimin e të drejtës së pensionit invalidor	
Gjendja aktuale	15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës deri në paraqitjen në kontroll mjekësor
Gjendja e ardhshme	Shkurtimi i afatit, rrjedhimisht pas kompletimit të dokumentacionit
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI
6. Intensifikimi dhe përparimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e SPI	
Gjendja aktuale	Pamundësi për realizimin e të drejtave të SPI për shkak mungesës së marrëveshjeve

	ndërkombëtare me disa vende
Gjendja e ardhshme	Lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare për realizimin e të drejtave të SPI
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI

Pagesë e rregullt, e saktë dhe në kohë e pensioneve në Vend dhe jashtë vendit në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital.

1. Përsosmëria e procesit për pagesën e pensioneve	
Gjendja aktuale	Vërtetimet për jetë dorëzohen nga ana e përfituesve të pensionit dy herë në vit. Punë me dosjet financiare dhe dokumentacioni i marrë në formë letre (fizikisht lëviz lënda nga një punonjës në tjetër). Për përfituesit e pensionit, anëtarë në shtyllën e dytë, vërtetim mbi të dhënat për pagesë në formë letre
Gjendja e ardhshme	Shkëmbimi elektronik i të dhënave me vendet e ish republikave Jugosllave për përfituesit e pensionit të cilët pranojnë pension nga R.Maqedonisë së Veriut (përfitues të ndjerë). Puna me dosje financiare dhe dokumentacioni i marrë në formë elektronike (dokumente të skanuara) Për përfituesit e pensionit anëtarë në shtyllën e dytë, vërtetim mbi të dhënat për pagesë në formë elektronike
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare
2 Pagesë e rregullt e pensioneve	
Gjendja aktuale	Pagesa në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe vendet e huaja bëhet në një afat të caktuar brenda muajit-rregullisht
Gjendja e ardhshme	Pagesa e harmonizimit të përfitimeve pensionale në mbështetje me vendimet e Qeverisë së R.Maqedonisë së Veriut
Përgjegjës	Sektori për çështje financiare
3. Ndërprerja në kohë e pagesës së përfituesve të ndjerë të pensionit	
Gjendja aktuale	Ndërprerja e pagesës së përfituesve të ndjerë të pensionit bëhet përmes njoftimit nga palët apo përmes raporteve mujore të përgatitura nga

	Drejtoria për udhëheqjen e librave amë në formë letre.
Gjendja e ardhshme	Lidhje elektronike e sistemeve informatike të të dy institucioneve (FSPIM-së dhe DULA) dhe marrja e informacioneve për përfituesit e ndjerë të pensionit në nivel diotor me qëllim të ndërprerjes në kohë të pagesës dhe shmangies së procedurave të mëtutjeshme për pagesën e borxhit në mënyrë gjyqësore.
Përgjegjës	Spektori për çështje financiare dhe Spektori i informatikës
4. Kontrolli i brendshëm	
Gjendja aktuale	Analizë e proceseve dhe vlerësimi i kontroleve për përgjegjësitë në çdo fazë të procesit. Sistem i përforcuar i kontrollit të brendshëm, reduktimi i gabimeve dhe mundësive për keqpërdorime eventuale nga ana e punonjësve.
Gjendja e ardhshme	Të shtohet vlera në kryerjen e detyrave në çdo fazë të procesit, të ngrihet sjellja etike e të gjithë punonjësve. Puna e revizionit të brendshëm të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për zbatimin e revizionit, revizorë të autorizuar.
Përgjegjës	Seksioni për revizion të brendshëm
5. Menaxhimi financiar	
Gjendja aktuale	Menaxhimi me financat e Fondit në mbështetje të mjeteve të tij të disponueshme dhe udhëheqje racionale dhe ekonomike me të njëjtat.
Gjendja e ardhshme	Përparimi i menaxhmentit financiar me qëllim të shfrytëzimit efikas, efektiv dhe ekonomik të mjeteve të Fondit të SPIMV-së.
Përgjegjës	Spektori për çështje financiare

Ligjshëri në punë dhe zbatimin e dispozitave materiale nëpërmjet revizionit të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohen të drejtat e SPI-së

1. Kontrolli i plotë i ligjshërisë të të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohet

e drejta e SPI-së	
Gjendja aktuale	Revizion i të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohet e drejta për SPI
Gjendja e ardhshme	Revizion i të gjitha aktvendimeve të sjella me të cilat përcaktohet e drejta e SPI-së në afat prej 15 ditësh nga sjellja e tyre nga ana e Seksionit për revizion dhe normativë
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI

Bazë e saktë, cilësore dhe azhurnuese e të dhënave për të gjithë të siguarit, obligues për pagesën e kontributeve të sigurimit pensional dhe invalidor

1. Të dhëna të sakta, të plota dhe azhurnuese	
Gjendja aktuale	Të dhënat Fondi i merr në mënyrë elektronike nga institucionet kompetente dhe subjektet afariste
Gjendja e ardhshme	Shkallë më e lartë e shkëmbimit të të dhënave dhe sigurimi i harmonizimit me bazat e të dhënave me institucionet tjera kompetente
Përgjegjës	Sektori për realizimin e të drejtave të SPI

Shërbimi profesional dhe përsosmëria e tij e vazhdueshme profesionale dhe monitorimi i pagesave të pa baza të Fondit

1. Kompletimi i Shërbimit profesional	
Gjendja aktuale	Mungesë e kuadrove profesionale që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve
Gjendja e ardhshme	Trajnimi i punonjësve nga ana e kuadrove profesionale dhe nëpërmjet seminareve
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
2. Pagesë cilësore, efikase dhe në kohë e kërkesave të Fondit	
Gjendja aktuale	Në mënyrë preventive të rritet kontrolli i lëndëve me pagesë të pa bazë të dëmit

Gjendja e ardhshme	Reduktim i pagesave të pa baza, dëmeve të Fondit. Informim në kohë i Këshillit drejtues të Fondit të SPIMV-së
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
3 Profesionalizimi i shërbimit profesional dhe Ekipit të menaxhimit në mbështetje me kërkesat moderne	
Gjendja aktuale	Vijimi i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme
Gjendja e ardhshme	Vijimi i seminareve të ndryshme dhe punëtorive që janë profesionale dhe të specializuara në aspektin e menaxhimit me resurset njerëzore
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
4. Sigurimi i kushteve moderne për punë	
Gjendja aktuale	Kushtet pjesërisht të papërshtatshme të punës
Gjendja e ardhshme	Ndërmarrja e masave me qëllim që të rritet motivimi dhe kënaqësia e punonjësve me çka do të rritej produktiviteti i punës.
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme.

Përdorimi i sistemit modern të informatikës i cili siguron mbrojtjen maksimale të të dhënave të klientëve.

1. Mirëmbajtja dhe mbrojtja e plotë e sistemit të informatikës	
Gjendja aktuale	Mirëmbajtje me resurset personale edhe nga firmat e jashtme
Gjendja e ardhshme	Ndjekja e trendeve botërore
Përgjegjës	Sektori i informatikës
2. Zhvillimi i sistemeve të informatikës, përkatësisht kontinuitet i rritjes së efikasitetit të proceseve afariste	
Gjendja aktuale	Automatizimi i proceseve afariste, ndjekja e zhvillimit të sektorit të IT- së dhe punët aktuale

Gjendja e ardhshme	Përkrahje proporcionale e sistemeve afariste për zbatimin efikas të proceseve afariste
Përgjegjës	Sektori i informatikës
3. Përkrahje e sistemit për teknologjinë e informatikës	
Gjendja aktuale	Mjete buxhetore personale.
Gjendja e ardhshme	Gjendja e ardhshme t'i përkushtohet resurseve të brendshme dhe punësimit të kuadrove të reja dhe rritja e buxhetit.
Përgjegjës	Sektori i informatikës


Sigurimi i kushteve optimale për jetesë në shtëpitë e përfituesve të pensionit.

1. Përpunimi i softuerit aplikativ për rangim elektronik dhe strehim në shtëpitë e pensionistëve	
Gjendja aktuale	Rangimin dhe strehimin e kryen Komisioni nga shërbimet profesionale të Fondit
Gjendja e ardhshme	Me softuerin aplikativ do të eliminohet vendimmarrja e faktorit njeri për rangimin dhe strehimin në shtëpitë e pensionistëve.
Përgjegjës	Sektori për resurse njerëzore, juridike dhe punë të përgjithshme
2. Renovimi i një pjese të shtëpive të pensionistëve që janë në gjendje të keqe për përmirësimin e kushteve për jetesë të përfituesve të pensionit	
Gjendja aktuale	Një pjesë e shtëpive për jetesë është renovuar, ndërsa një pjesë nuk është renovuar për një periudhë më të gjatë dhe nuk kanë kushte për jetesë të gjithë përfituesit e pensionit të strehuar në to
Gjendja e ardhshme	Me renovimin e të gjitha shtëpive për jetesë do të sigurohen kushte të njëjta për të gjithë përfituesit e pensionit në shtëpitë

Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë të Bashkimit Evropian dhe përforcimi i kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinim të sistemeve të sigurisë sociale.

1. Plotësimi i standardeve të BE-së	
Gjendja aktuale	Pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtë të Bashkimit evropian dhe përforcimi i kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinim të sistemeve të sigurisë sociale.
Gjendja e ardhshme	Pjesëmarrja e punonjësve të Fondit të SPIMV-së në projektin INPP “Përforcimi i kapaciteteve për zbatimin efektiv të të drejtës së BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve, nga janari i vitit 2019
Përgjegjës	Spektori për realizimin e të drejtave të SPI-së
2. Bashkëpunim me fondet e pensioneve kombëtare të huaja	
Gjendja aktuale	Gjatë zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social nga ana e të dyja palëve kontraktuese, nënshkruese të marrëveshjes respektohen parimet e trajtimit të barabartë, përcaktimi i legjislacionit i cili do të zbatohet, ruajtja e të drejtave të arritura dhe pagesa (eksport) e pensioneve (beneficione)
Gjendja e ardhshme	Iniciativë për lidhjen e marrëveshjeve të reja për sigurim social dhe ndryshimet dhe plotësimet eventuale të marrëveshjeve të lidhura .
Përgjegjës	Spektori për realizimin e të drejtave të SPI-së

PLANI STRATEGJIK I FONDIT TË SPIMV-së
2020 – 2022



4. LIDHJA E PLANIT STRATEGJIK ME BUXHETIN

Të dalat e planifikuara të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut për periudhën 2020-2022.

<i>Përshkrimi i të dalave</i>	<i>Viti 2020</i>	<i>Viti 2021</i>	<i>Viti 2022</i>
Gjithsej pensione	58.172,99	60.271,09	62.686,37
Fondet pensionale private	8.147,49	8.743,49	9.390,18
Kompensime	96,62	96,62	96,62
Kontribut për shëndetësi	7.562,49	7.835,24	8.149,23
Shërim në banjë dhe transport	38,00	38,00	38,00
Paga dhe kompensime	282,20	295,75	310,24
Të dalat të tjera	175,00	175,00	175,00
Shpenzime kapitale	8,47	8,47	8,47
Punë ndërtimore	10,00	10,00	10,00
Blerja e një automjeti	1,53	1,53	1,53
<i>Gjithsej të dala</i>	74.494,78	77.475,19	80.865,63

Indikatorë

Përfitues të pensionit	Numri i përfituesve
Viti 2020	327.125 përfitues
Viti 2021	332.163 përfitues
Viti 2022	337.278 përfitues

Numri i të punësuarve në Fondine SPIMV-së	
Viti 2020	630 punonjës
Viti 2021	650 punonjës
Viti 2022	660 punonjës

SWOT ANALIZË

F a k t o r ë t e b r e n d s h ë m	Strengths (Përparësi)	Weaknesses (Dobësi)
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Servisim i suksesshëm i shërbimeve ndaj të siguarve dhe përfituesve të së drejtës për SPI 2. Implementim i standardit ISO 9001:2015 3. Shumica e punonjësve me përvojë dhe kompetent 4. Infrastruktura e IT-së dhe proceset e automatizuara afariste 5. Procedurat e përcaktuara dhe qartë të definuara me kontrolle të mira të procesit 6. Aktet ligjore (rregulativa) 7. Shkëmbimi i të dhënave elektronike me institucione tjera 8. Dorëzimi elektronik i kërkesës për pension 9. Monitorimi elektronik i stazhit të sigurimit 10. Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit për matjen e kënaqësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i reduktuar i punonjësve, posaçërisht nga profili mjekor dhe ai i informatikës 2. Matja dhe standardizimi i punës së çdo punonjësi apo seksioni 3. Mosrrespektimi i kriterëve për avancimin e punonjësve 4. Mungesa e trajnimeve, e cila rezulton që një pjesë e kuadrit të jenë jo profesional dhe të paedukuar në përputhje të specifikave të veprimtarisë së Fondit. 5. Ekzistenca e punonjësve të painteresuar dhe të pamotivuar si rezultat i pagave të ulëta dhe mbingarkesës me detyra të punës (shpërndarje e pabarabartë e punës) sipas kryerësve 6. Një pjesë e filialeve dhe ekspoziturave janë në kushte të vështira pune për shkak të mungesës së mjeteve për mirëmbajtjen e vazhdueshme 7. Mospërputhja me afatet për punë 8. Nuk matet kënaqësia e punonjësve
F a k t o r ë t e j a s h t ë m	Opportunities (Mundësi)	Threats (Kërcënime)
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përmirësimi i proceseve me ndihmën e IT-së 2. Trajnimi dhe edukimi i të punësuarve 3. Thjeshtësimi i procedurave të sportelit (reduktim i hapave të cilët duhet ti bëjnë shfrytëzuesit e shërbimeve me qëllim të përfundimit të punës – “gjithçka në një vend”) 4. Shkëmbimi i të dhënave elektronike në nivel ndërkombëtar 5. Shërbime të reja për shfrytëzuesit e shërbimeve në Fondin e SPIMV-së 6. Gjetja e burimeve të reja të financimit 7. Mbështetje më e madhe nga institucionet tjera (MPPS, Ministria e Financave, MIOA etj.) 8. Ndarje e barabartë e lëndëve nëpër fililale 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktvendime ligjore me të cilat vështirësohen proceset për realizimin e të drejtës të SPI 2. Ndryshime të shpeshta të rregulativës ligjore dhe akteve nënligjore të cilët ndikohen nga puna e FSPIMV-së 3. Mungesa e analizës financiare (implikimet financiare ndaj Fondit të SPIMV-së) gjatë miratimit të rregulativës ligjore që ndikon ndaj punës së institucionit 4. Mospranimi i vërejtjeve nga Fondi i SPIMV-së gjatë miratimit të aktvendimeve ligjore që kanë ndikim 5. Dokumentacion i pavlefshëm (për stazh, dokumentacion mjekësor dhe çdo gjë tjetër që ndikon në realizimin e të drejtës të SPI) 6. Shuma të paalocuara për kontribut nga SPI 7. Varësia nga Buxheti i RMV-së 8. Mungesa e personelit si rezultat i pengesave ligjore 9. Shpërngulja e popullatës së aftë për punë

Me vendosjen e kontekstit, përkatësisht swot analizës, Fondi I SPIMV-së i definon parametrat e jashtme dhe të brendshme të cilët merren parasysh gjatë punës.

Kontekst i brendshëm është mjedisi i brendshëm në të cilin organizata ka për qëllim të arrijë qëllimet e veta.

Kontekst i brendshëm janë faktorët të cilët në kuadër të Fondit të SPIMV-së mund të ndikojnë në përmbushjen e qëllimeve.

Konteksti i brendshëm i përfshin vendet e dobëta dhe të fuqishme të Fondit të SPIMV-së edhe atë:

1. Anët e fuqishme

- Servisim të suksesshëm të shërbimeve ndaj të siguarve dhe përfituesve të së drejtës të SPI-së
- Implementimi i standardit ISO 9001:2015
- Shumicë e punonjësve me përvojë dhe kompetent
- Infrastruktura e IT-së dhe proceset afariste të automatizuara

Nr. _____
Shkup, gusht 2019

KËSHILLI DREJTUES
Kryetar,
Boro Varoshlija